

Eksperti zviceran dr. Solioz: 8 qershori rast i mirë për kthimin e imazhit të Kosovës

GJENEVË, 6 maj -“Popullariteti i Hashim Thaci ka rënë dukshëm sigurisht për shkak papunësisë së madhe dhe korrupsionit në Kosovë..” thotë ne një intervistë për agjencinë e lajmeve “Presheva Jonë” profesori zviceran dr. Christophe Solioz, analisti i njohr politik dhe ekspert ndërkombëtar për çeshje ballkanike.



Solioz: Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë mun dtë sjellin fqinjësi të mirë, por jo edhe anëtarësimin e Kosovës në OKB

“Meqë për këtë nuk vendos as Prishtina e as Beogradi por vendet anëtare të KS të OKB-së dhe dihet për momentin se çfarë qëndrimesh ka sot Rusia dhe Kina. Kosova nuk mund të hyjë direkt si anëtare e plotë e OKB-së para se të bëhet fillimisht si vëzhguese që për këtë nevojitet ende kohë”.

“Qeveritarët kosovarë para se të flasin për anëtarësimin e Kosovës në OKB, kanë obligime dhe detyra të tjera shumë më urgjente dhe të rëndësishme për t'i kryer. Unë nuk mendoj se Kosova do të pranohet njëherë anëtare e OKB-së, së paku jo para vitit 2030-të. Këtë e them jo pse Kosovën ende e kanë njohur vetëm 106 vende, por Kosova ka ende shumë rekomandime pa realizuar të parashtruara nga komuniteti ndërkombëtar”, ka thënë ai.

Sipas z.Soliz brengësëse është edhe ngadëlisimi i procesve të ingreimeve dhe lobi i njohjeve. Qeveritarët kosovarë para se të flasin për anëtarësimin e Kosovës në OKB, kanë obligime dhe detyra të tjera shumë më urgjente dhe të rëndësishme për t'i kryer. Fillimisht Kosova duhet të punojë në kthimi e imazhit dhe të pretendoj si hapë të parë anëtarësimin e saj në BE e pastja të mendoj për anëtarësime tjera si në OKB apo NATO që sipas mendimit tim kjo nuk do të nddhë para vitit 2030..”

Lidhur me situatën aktuale në Kosovë, 14 vjet pas lufte porsiori zviceran Soliz në vazhdim duke cilesuar situatën e mirë në Kosovë ka shtuar se “situata e pasluftës padyshim është shumë më mirë, por megjithatë në rajon ka mbetur edhe shumë për t'u bërë për të folur për një situatë vërtetë stabile. Sot ndër problemet me shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar janë korrupsioni dhe krimi i rajonit që ka përfshirë rajonin si në Kosovë ashtu edhe në Serbi e më gjerë... Ne jemi të shqetësuar gjithashtu se proceset në rajon po zhvillohen me një dinamizëm dhe ndryshime. Ballkani mund të luaj rol të jashtëzakonshëm për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Duke folur për dialogun Kosovë-Serbi eksperti zviceran për çështje të ballkanin ka pohuar se “Kurrënjëherë unë nuk i kam konsideruar si tradhtarë të Kosovës miqtë e mi nga Kosova të cilët i njoh kaheerë ishin të angazhuar bashkë me mua për dialog dhe bashkëpunim me Beogradin. Edhe unë jam për pavarësinë e Kosovës por jo kështu, jo me disa njerëz në qeveri cka jo rastësisht është kërkuar një qeveri më serioze dhe me duar të pastra. Une përshëndes personlitetet që janë në favor të dialogut dhe marrëvshjeve, bashkëpunimit me vendet limitrofe, rajonale. Me këtë deshta të them se në Serbi nuk janë gjithë kundër pavarësisë së Kosovës dhe nëse sot jo, nesër sigurisht po, Serbia do ta njoh shtetit e Kosovës. Për mua pavarësia e Kosovës e legjitimuar tashmë edhe nga Gjykata Ndërkombëtare aktualisht është teorike dhe ende jo kualitative i cili proces do të zgjas ende sepse ka edhe shumë cka për t'u drejtuar në rajon. “